

Shtojea 20

**FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE  
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor: **Agjencia e Blerjeve të Përqendruara**  
Adresa: **Blv "Dëshmorët e Kombit" Nd. 1, 1001, Tiranë.**

Ankesë drejtuar: **Komisionit të Prokurimit Publik**

**Sekzioni I. Identifikimi i ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatoresh ekonomike)*

**NRG shpk**

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

**L13426006B**

Nuis/Nipt

**Farkë, Rruga "Eduart Mano", Pallatet Nr. 10, Kopshti Zologjik, Selitë**

Adresa

Tiranë

Qyteti

Shqipëri

Shteti

Kodi Postar / Posta

**(+355) 672031918/9**

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

**info@nrg.com.al**

E-mail

**Flutura NUREDINI – Administratore**

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)



Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

**2023/04/25**

Data (viti/muaji/dita)

**(+355) 672031918/9**

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Sekzioni II. Informacion mbi procedurën

### 1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e references se kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*

**REF-66564-04-19-2023**

### 2. Lloji i Procedurës

*Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.*

**Procedurë e hapur**

Procedurë e hapur e thjeshtuar

**X**

Procedurë e kufizuar

Procedurë konkuruese me negocim

Partneritet për inovacion

Dialog konkurrues

Procedurë me negocim me shpallje paraprake  
të njoftimit

Procedurë me negocim pa shpallje  
paraprake të njoftimit të kontratës

Shërbim Konsulencë

Konratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga  
procedurat e prokurimit të parashikuara në  
LPP

### 3. Autoriteti /Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

**Ajgencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara**

### 4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

*(Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)*

**43,165,933 (dyzetë e tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) Lekë (pa TVSH)**

### 5. Objekti i kontratës/Marreveleshje Kuadër

*(Përvizimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveleshje kuader).*

## **Loti 6 – me objekt: "Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Vlorë"**

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

(*Data (viti/muaji/dita)*)

2023/05/22

7. Data e publikimit te Njoftimit te Fituesit

(*Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme*)

8. Data e nënshkrimit të kontratës

(*Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës*)

---

### **Sekcioni III. Përshkrimi i ankesës**

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

**Hartimi i kritereve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike nuk është bërë në pwrputhje me LPP dhe RrPP.**

#### **2. Objekti i ankesës**

- **Modifikim i dokumentave të tenderit**

**X**

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(*Citoni këtu arsyet e skualifikimit*)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

**□**

(*Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime*)

- Pavlefshmëri kontrate

**□**

(*Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë*)

- Tjetër

□

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

### **3. Rrethanat dhe faktet**

*Përshkruani rrethanat e faktit.*

**Hartimi i kritereve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike nuk është bërë në pwrputhje me LPP dhe RrPP.**

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përsë pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

Pasi u njohëm me DT të procedurës së prokurimit me objekt "Loti 6 – me objekt: "Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Vlorë" konstatuan disa mangësi në hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të kualifikimit.

Neni 110, pika 1 e Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" parashikon se:

*1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njofimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

Neni 97, pika 1 e V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, parashikon se:

*1. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:*

- a) *brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njofimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*
- b) *brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njofimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.*

Bazuar sa më sipër po paraqesim këtë formular ankesë duke kërkuar modifikimin e kritereve të kualifikimit, specifikimeve teknike si dhe duke kërkuar disa sqarime.

Neni 77 i Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” parashikon se:

*Neni 77*

*Kërkesat për kualifikim*

*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të janë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të janë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japid informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitit dhe pasivit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërcohët nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërcohët operatorëve, duke iu referuar grupave të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zoterojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesit kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kritereve.

Neni 41 i V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar parashikon se:

#### ***Neni 41***

##### ***Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve***

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përbushjen e këtyre kritereve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

*Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetimë të lëshuara nga një ent publik për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatumore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatumore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatumore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Në rastin e procedurave të prokurimit "Shërbim konsulence", si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuginë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbrushur konratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit "Shërbim konsulence", stafi i angazhuar të paragesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

- a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbrush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërcohët për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit te interesit, sipas legjislacionit në fuqi.
- c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.
- c) operatori ekonomik të paragesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të konratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përllogaritur.

Edhe pse LPP dhe RrPP kanë përcaktuar qartë se çfarë dokumentacioni duhet të kerkohet, Njësia e Hartimit të Dokumentave të Tenderit nuk ka përcaktuar kritere për të vërtetuar kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë dhe konkretisht:

- a) licenca profesionalë për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) futinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përm bushur kontratën.

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktor të shtojë si kritere të domosdoshme dhe ligjore kriteret e kualifikimit për:

- licensën profesionalë për realizimin e shërbimeve të OE,
- drejtuesin teknik dhe specializimin që duhet të ketë ky i fundit,
- futinë punëtore dhe çertifikatat e tyre profesionale,
- mjetet dhe pajisjet teknike për të përm bushur kontratën.

Sjellim në vëmendjen e Autoritetit Kontraktor se në dokumentat e tenderit të herës së kaluar të gjitha këto dokumenta ishin përcaktuar si kritere kualifikimi, pavarësisht se Komisioni i Prokurimit Publik vendosi modifikimin dhe jo heqjen e tyre, modifikim i cili nuk u bë pasi procedura e prokurimit u annullua (vendimi i K.P.P. nr. 6422022 datë 04.07.2022).

Ajo që bie në sy është qëndrimi ekstremisht i kundërt i Autoritetit Kontraktor i cili në procedurën e parë të prokurimit kishte kërkuar kritere kualifikimi (megjithëse të ekzagjeruara) kurse në procedurën konkrete nuk ka kërkuar fare kritere kualifikimi teknike dhe profesionale duke e vlerësuar këtë shërbim një shërbim të rëndomtë (kur është një shërbim shumë i rëndësishëm me impakt në mjedis, në jetën dhe shëndetin e popullatës apo në florën dhe faunën) i cili mund të kryhet nga çdo operator ekonomik (edhe po nuk patën licensë profesionale, apo drejtues teknik, apo nuk disponojnë fare personel teknik dhe mjetë apo pajisje në pronësi apo me qera).

Si do të bindet Autoriteti Kontraktor që një operator ekonomik është i aftë të realizojë këtë shërbim me cilësine e kërkuar dhe brenda afateve kur nuk ka kërkuar asnë dokument kualifikues për tu bindur se ai ka aftësinë teknike dhe profesionale të realizojë shërbimin e kërkuar?!

Në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është kërkuar paraqitja e Formularit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe Formularit të Listës së Shërbimeve sipas Shtojcës 2 prandaj kërkojmë që të shtohet tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pika 1 edhe paraqitja e këtyre dy Formularëve (ashtu sikurse është kërkuar paraqitja e Formularit Përmbledhës së Vetdeklarimit sipas Shtojcës 9 dhe Sigurimi i Ofertës sipas Shtojcës 3).

Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar “2.3 Kapaciteti teknik:

1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njofitimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit te Lotit 1. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*
  - a) *Kur sherbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkeseve të legjisacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e sherbimeve të realizuara.*
  - b) *Kur sherbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkeseve të legjisacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e sherbimeve të realizuara”*

Neni 41, pika 3 e V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar parashikon se:

**Neni 41**  
**Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve**

*3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njofitimit të kontratës.*

*Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetimë të lëshuara nga një ent publik për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkeseve të legjisacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkeseve të legjisacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbimi konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të nijhen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

Kërkojmë që ky kriter kualifikimi të modifikohet sipas pikës 3 të nenit 41 të V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimkit publik” i ndryshuar.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar “Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar “2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit te lotit 1. Kriteri konsiderohet i përbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.”*

Neni 41, pika 3 e V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimkit publik” i ndryshuar parashikon se:

*Neni 43  
Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare*

1. *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare<sup>1</sup>.*
2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:
  - a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit<sup>2</sup>, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
  - b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;
  - c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulencë”.*
3. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Kërkojmë që ky kriter kualifikimi të modifikohet sipas pikës 2 të nenit 41 të V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimkit publik” i ndryshuar.

---

Riformuluar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

<sup>2</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Në Ligjin nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, në nenin 2, nenin 8 dhe 9 parashikohet:

*Neni 2*

*Ky ligj përcakton dhe rregullon:*

- a) vendosjen në treg të lëndëve biocide, produkteve biocide dhe produkteve të trajtuar;
- b) prodhimin, importin dhe eksportin e lëndëve biocide, produkteve biocide dhe produkteve të trajtuar;
- c) organizimin dhe funksionimin e kontrollit të organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, në mjeshterësi publike dhe private, përmes produkteve biocide.

*Neni 8*

*Autorizimi për bërjen të disponueshme për treg të produkteve biocide*

1. Të gjitha lëndët vepruese dhe produktet biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, që hyjnë, prodhohen dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen të disponueshme për treg pas pajisjes me autorizim nga autoriteti kompetent.

2. Autoriteti kompetent autorizon produktet biocide, duke lejuar bërjen të disponueshme për treg në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas paraqitjes së dokumentacionit nga personi fizik ose juridik dhe verifikimit nëse dosja i përbush kërkeshat, sipas këtij ligji.

3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, për raste të gjendjeve të emergjencës shëndetësore apo emergjencës civile, kur luftimi i një agjenti biologjik të dëmshëm gjykohet se nuk realizohet me produktet biocide të autorizuara, autorizon importimin dhe përdorimin e kufizuar të produkteve biocide të paautorizuara përmes procesit normal të bërjes së disponueshme për treg. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë deri në 4 muaj dhe për një sasi të argumentuar nga Instituti i Shëndetit Publik, sipas emergjencës.

4. Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për: a) produkte biocide të prodhua në vend; b) produkte biocide të autorizuara në njërin nga vendet e Bashkimit European, në Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Turqi, Izrael dhe Australi; c) produktet biocide të prodhua dhe të autorizuara në vendet e Ballkanit.

5. Rregullat për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurën e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

*Neni 9*

1. Produktet biocide vendosen në treg pasi janë autorizuar, sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Vendosja në treg e produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, të cilët, pavarësisht nga sasia e produktit, plotësojnë kriteret e mëposhtme: a) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë të kontraktuar një person, në pozicionin e drejtuesit teknik, të diplomuar në degët biologji, kimi, agronomi ose shëndet publik; b) kanë mjeshterësi të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit, garantojnë kushte për sigurinë e personelit; c) kanë klasifikuar, paketuar dhe etiketuar produkte

*biocide, sipas dokumentacionit të autorizimit të produktit; ç) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë mqedise të veçanta tregtimi.*

Në Kreun 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, parashikohet shprehimi shtesë:

*1. Dosja e aplikimit për autorizim për vendosjen në treg të produkteve biocide, së bashku me kërkësën për pajisjen me autorizim, përmban dokumentet e mëposhtme:*

*a) Një dosje dhe letër aksesi për produktin biocid, që plotëson kërkësat e përcaktuara në shtojcën III të këtij vendimi;*

*b) Një përbledhje të karakteristikave të produktit biocid, përfshirë: - emrin tregtar të produktit biocid; - emrin dhe adresën e aplikantit; - përbërjen cilësore e sasiore të produktit lidhur me lëndët vepruese dhe lëndët e tjera jovepruese, si dhe njohuri të domosdoshme për përdorimin e duhur të produktit biocid; - prodhuesit e produktit biocid (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit); - prodhuesit e lëndëve vepruese (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit); - tipi i formulimit të produktit biocid; - frazat e rrezikut dhe parandalimit; - tipi i produktit biocid dhe një përshtrim i saktë i përdorimit për të cilin kërkohet autorizimi; - organizmat target; - dozat e aplikimit dhe udhëzimet për përdorimin; - kategoritë e përdoruesve; - të dhëna mbi ndikime të mundshme direkte apo indirekte të produktit biocid në mqedis dhe përcaktimin e masave përkatëse për minimizimin e këtyre ndikimeve në mqedis; - udhëzues për nxjerjen e sigurt jashtë përdorimit të produktit dhe ambalazhit; - kushtet e ruajtjes dhe jetën e ruajtjes së produktit biocid për kushte normale të ruajtjes; - informacion tjeter relevant rrëth produktit biocid.*

*c) Një dosje dhe letër aksesi për çdo lëndë vepruese të miratuar, që përbahet në produktin biocid, që plotëson kërkësat e përcaktuara në shtojcën II të këtij vendimi;*

*ç) Letra e aksesit duhet të përbajë së paku informacionin e mëposhtëm: - emrin dhe detajet e kontaktit të zotëruesit të të dhënavës dhe personit të tretë; - emrin e substancës vepruese ose të produkteve biocide për të cilat është i autorizuar përdorimi i të dhënavës; - datën në të cilën letra e aksesit hyn në fuqi; - një listë të të dhënavës të paraqitura për të cilat letra e aksesit i jep të drejtën e citimit.*

*d) Aplikanti nuk ka nevojë të paraqesë të dhëna për ekspozimin, nëse nuk parashikohet ekspozim që shoqëron përdorimet e propozuara dhe nuk është e nevojshme shkencërisht që të paraqiten të dhëna, apo nuk është teknikisht e mundur që të prodhohen të dhëna të tilla;*

*dh) Të dhënat që provojnë se produkti biocid është i autorizuar në një nga vendet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 8, të ligjit nr. 95/2015, dhe është i përfshirë në bazën e të dhënavës të Agjencisë Evropiane të Kimikateve për produktet biocide të autorizuara. Aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që zotëron autorizimin e këtij produkti biocid, të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe;*

*e) Për produktet biocide që janë subjekt i procedurës së thjeshtuar të autorizimit, sipas përcaktimeve në kreun IV, të shtojcës I, të këtij vendimi: - një përbledhje të karakteristikave të produktit biocid, sipas referimit në pikën 1(a) të këtij kreu; - të dhënat e efikasitetit; dhe - çdo*

*informacion tjetër relevant në mbështetje të konkluzionit se produkti biocid plotëson kushtet e përcaktuara në kreun IV të këtij vendimi; - të dhënrat që provojnë se aplikantit i është lëshuar autorizimi i produktit biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që e ka marrë autorizimin e këtij produkti biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian; të përkthyera dhe të noterizuara në gjuhën shqipe.*

*ë) Etiketën përkatëse të produktit biocid, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 487, datë 29.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e produkteve biocide";*

*f) Dokumentacioni me të dhënrat e sigurisë (MSDS) për produktet biocide në gjuhën shqipe dhe angleze, në formë të printuar dhe elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kimikatet.*

*g) Mostrën e produktit biocid me paketimin dhe etiketën në gjuhën shqipe, siç do të hidhet në treg; gj) Licencën e QKB-së për vendosjen në treg të produkteve biocide;*

*h) Lejen mjedisore, me emërtimin përshtkrues të veprimtarisë sipas shtojcës 1, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar;*

*i) Faturën e pagesës së aplikimit.*

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përbushje me sukses të konratës.

Në varësi të konratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të janë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

**Kriteret e përcaktuara me ligji parashikohen nga ligji për prokurimin publik dhe rregullat në përputhje me të, gjithashtu mund të përcaktohen kritere të cilat bazohen në ligje specifike, në varësi të fushës apo objektit që kërkohet të realizohet.**

Referuar procedurës konkrete, konstatojmë se blerja e mallit nga subjektet të cilat ofrojnë shërbimin objekt prokurimi, ka një rregullim të posaçëm ligjor dhe kryhet sipas disa procedurave specifike, duke u shoqëruar me dokumentacion përkatës, për vendosjen e tyre në treg (Ligji 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe rregullat në zbatim të tij).

Sa më sipër, referuar Ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe rregullat në zbatim të tij, produktet për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi, pajisen me dokumentacion përkatës për vendosjen e tyre në treg në Republikën e Shqipërisë dhe duke qenë se për këtë procedurë ka një rregullim specifik, autoriteti kontraktor duhet të kërkojë për këto produkte dokumentacion shoqërues si i parashikon ligji i posaçëm.

Në specifikimet teknike AK citon ”Produktet Biocide autorizohen në vendin tonë sipas V.K.M. nr. 933 datë 25.11.2020 ”*Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg*”.

VKM nr. 933 date 25.11.2020 e cila parashtron qartë dhe pastër çfarë dokumentacioni duhet të plotësoj një operator ekonomik për marrjen e lejes se importit të produkteve biocide nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale. Në bazë të V.K.M. nr. 933 datë 25.11.2020, operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale dokumentet si më poshtë;

- Leter aksesi për lëndën aktive e rregjistruar në ECHA
- Një përbledhje të karakteristikave të produktit biocid e cila mund te shkarkohet nga ECHA (ku përfshihen karakteristikat, habitatet e synuara, dozat e perdonimit, etj).
- Leter aksesi per produktin e rregjistruar në ECHA
- Autorizim prodhuesi
- Etiketen në gjuhën Shqipe dhe të origjinës
- MSDS ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen e origjines
- Çertifikat rregjistrimi ne Europe, Kanada ose ne USA ne gjuhen Shqipe dhe te origjines

Për sa i përket pjesës teknike dhe zgjedhjes së produkteve, referenca tek V.K.M. 933 date 25.11.2020 është e qartë, pra se si përbërësi aktiv ashtu edhe formulimi (produkti biocid) duhet të jen të regjistruara në ECHA, (Agjencia Evropiane e Kimikateve).

Ligji i 95/2015 parashikon mundësinë e regjistrimit në Republikën e Shqipërisë të produkteve që janë të regjistruara në vende si Bashkimi Evropian, Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Turqi, Izrael dhe Australi dhe në tendër del qartë se, këto biocide duhet të jen të autorizuara në ECHA, por nuk është e qartë nëse vlera e autorizimit në ECHA mbizotëron mbi atë të vendit të origjinës nga i cili është paraqitur autorizimi. Me fjalë të tjera, në rast mospërputhjeje midis parametrave teknikë të aplikimit, përdorimit, habitateve të synuara, qëndrueshmërisë, shpeshtësisë së

ndërhyrjeve, dozave, vlerësimeve të biocidit ose lëndëve aktive të rregjistruar nga Agjencja Evropiane ECHA, të cilat mund të gjenden në:

- 1) Faqja e detajeve të rregjistrimit në ECHA
- 2) Raportin e rregjistrimit në ECHA
- 3) Përbledhjen e karakteristikave të produktit biocid

apo do konsiderohen të dhënat e rregjistrimit që i përket vendit të origjinës, të paraqitura në fazën e aplikimit për rregjistrimin në Shqipëri (për shembull EPA Amerikane) ose DE (Departamenti Australian i Mjedisit) etj?? *Kërkojmë sqarime në lidhje me këtë pikë.*

Në listën e përbërësve aktivë të përdorshëm nuk përcaktohet doza MINIMUM që do të përdoret në bazë të sipërfaqes, por vetëm se rezultati pozitiv i shërbimit duhet të jetë kontrolli 100% i larvave, edhe këtu lind një problem në lidhje me përdorimin e dozën minimale, e cila duhet përcaktuar.

Për këtë duhet ti rreferredohemi autorizimit/rregjistrimit në ECHA apo madje mund të shkojë shumë më poshtë dozës minimale të autorizuar në ECHA, nëse kjo është e ndryshme nga doza e autorizuar në vendin nga i cili vjen rregjistrimi??. *Kërkojmë sqarime në lidhje me këtë pikë.*

Sa më sipër kërkojmë që të shtohet si kriter i detyrueshëm kualifikues, sipas V.K.M. nr. 933 datë 25.11.2020 “*Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg*” paraqitja e dokumentacionit:

- Autorizim prodhuesi ose Leje Importi.
- MSDS ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen e origjines.
- Certifikat rregjistrimi ne Europe, Kanada ose ne USA ne gjuhen Shqipe dhe te origjines.
- Produkti te jetë i **përfshirë në bazën e të dhënave të Agjencisë Evropiane të Kimikateve për produktet biocide të autorizuara.**

**Autoriteti kontraktor duhet të parashikojë në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik dhe profesionale, por edhe kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produkteve.**

Synimi bazë i autoritetit kontraktor duhet të jetë vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës.

Për përbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik dhe profesionale, por edhe kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produkteve.

Në interpretim të dispozitave ligjore të fushës së prokurimit, vlen të theksojmë se së pari, ligjvënësi ka parashikuar dy natyra kriteresh kualifikimi, kritere të cilat përcaktohen me ligj, si dhe kritere dhe kërkesa të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në përputhje me llojin, volumin, sasinë, specifikat e shërbimit që kërcohët të prokurohet, me qëllim realizimin me sukses dhe cilësi të tij.

Vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme pasi DT të hartuara në këtë mënyrë nuk përcaktojnë qartë momentin se kur duhet që O.E. të dorëzojnë dokumentacionin në lidhje me produktin përpara Autoritetit Kontraktor. Në eksperientat e viteve të kaluara ka patur raste të futjes së produkteve jo-cilësorë kontrabandë që natyrisht nuk ofronin cilësinë e duhur.

Në lidhje me pretendimet kërkojmë zhvillimin e një ballafaqimi me përfaqësues të Autoritetit Kontraktor dhe Institucionit që ka hartuar specifikimet teknike.

#### 5. Kërkesë për ekspertizë të posacme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

---

---

#### 6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

---

---

#### 7. Lista e informacionit konfidencial:

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përbledhje të përbajtjes.

**Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik**

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail: [info@nrg.com.al](mailto:info@nrg.com.al)

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori i NRG shpk

Flutura NUREDINI



